



DHUNA NË FAMILJE

**Përgjegjësitë që ka Policia e Shtetit për
parandalimin dhe reduktimin e saj**

Tiranë, mars 2008



UNDP/Japan WID Fund Support

Idetë e shprehura nga autorët e këtij botimi, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (UNDP) apo të Zyrës Japoneze për Gratë në Zhvillim (Japan WID)

FALENDERIME

Ky Manual u hartua në kuadrin e projektit “Dhuna në familje – jo më vetëm çështje familjare” (Projekti i Dhunës në Familje) të zbatuar nga Zyra e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri (UNDP Albania) me mbështetjen e fondit të Zyrës Japoneze për Gratë në Zhvillim dhe është rezultat i përpjekjeve dhe ndihmesës së një numri kontribuesish.

Manuali u hartua nga Prof. Dr. Ilirjan Mandro dhe Z. Fredi Agastra (Kryekomisar), me nje përvojë shumëvjeçare në punën policore dhe formimin profesional të efektivave të policisë në Shqipëri. Pa përkushtimin dhe njohuritë e tyre të gjera në këtë fushë, ky manual do të ishte i pamundur.

Projekti i Dhunës në Familje dëshiron t'i shprehë falenderimet Zj. Ricarda Amberg nga UNOPS, Vienë dhe Zj. Dolli Wittberger, për sugjerimet lidhur me modele manualesh të ngjashme në rajone të tjera të botës.

Manuali, nuk është një krijim tërësisht origjinal. Ai u mbështet mbi rezultatet, botimet apo projektet e filluara ose të përfunduara veçanërisht të Nismës për të Drejtat e Grave në Shqipëri (USAID), Organizatës Policore për Rajonin Jugor të Afrikës SARPCCO dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) dhe i përshtati ato për kushtet aktuale të punës policore në Shqipëri. U jemi mirënjohës drejtuesve dhe efektivave të Drejtorive të Policisë së Durrësit dhe Tiranës, të cilët dhanë komente të vlefshme për përmirësimin e Manualit

Së fundi dëshirojmë të shprehim falenderimet tona për Zyrën Japoneze për Gratë në Zhvillim që ka mbështetur financiarisht këtë projekt dhe këtë botim.

Emira Shkurti
Menaxhere Projekti
Projekti kundër Dhunës në Familje
UNDP Albania
Tiranë, më 25 mars 2008

PËRMBAJTJA

		Faqe
	Falenderime	
1.	Hyrje	7
2.	Kreu I	8
	DHUNA NË FAMILJE – SHKELJE E TË DREJTAVE TË NJERIUT	
3.	Kreu II	10
	STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE SHQIPTARE PËR DHUNËN NË FAMILJE	
	1. Standardet ndërkombëtare për dhunën në familje 2. Standardet shqiptare për dhunën në familje	
4.	Kreu III	20
	KUPTIMI MBI DHUNËN NË FAMILJE NË SHQIPËRI	
	1.Ç’është dhuna në familje-përkufizimi 2.Përmasat e dukurisë së dhunës në familje 3.Format e dhunës 4.Pasojat e dhunës mbi viktimat 5.Disa faktorë që ndikojnë në dhunën në familje 6.Strukturat e posaçme të Policisë së Shtetit që merren me trajtimin e rasteve të dhunës në familje	
5.	Kreu IV	27
	KUPTIMI MBI DHUNËN NË FAMILJE SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL DHE LIGJIT NR.9669, DATË 18.12.2006 “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”	
	1.Kuptimi i përgjithshëm sipas ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” 2. Kuptimi për dhunën në marrëdhëniet familjare në zbatim të legjislacionit penal, norma dhe procedura.	
6.	Kreu V	32

	<p>PROCEDURAT STRANDARDE QË DUHET TË ZBATOJË PUNONJËSI I POLICISË PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE</p> <p>1. Vështrim mbi praktikat e policisë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje 2. Ndërhyrjet e punonjësit të policisë në rastet e dhunës në familje 3. Detyrat e punonjësve të policisë që shërbejnë në sallat operative e të emergjencës 4. Përgjegjësitë dhe detyrat e patrullës së përgjithshme dhe punonjësit të policisë në zonë 5. Detyrat gjatë hetimit dhe intervistimit 6. Disa rregulla të përgjithshme 7. Detyrat e punonjësve të policisë për zbatimin e urdhërave të mbrojtjes 8. Trajtimi i rasteve të dhunës në familje kur dhunuesi është punonjës policie 9. Disa aspekte specifike që duhen vlerësuar gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Përfundim</p>	
7.	Shtojca A Format raporti policor për ngjarjen	50
8.	Shtojca B Formate kërkesë-padish për urdhëra të mbrojtjes	54
9.	Literatura Burimore	66

HYRJJE

Dhuna në familje në shoqërinë shqiptare është një problem që shfaqet me të gjitha format e saj, deri në ekstrem, duke u bërë gjithmonë e më i ndjeshëm në mbarë opinionin.

Ndër vite, Policia e Shtetit, dhunën në familje e ka vlerësuar së bashku me krimet e tjera, duke mos e veçuar dhe trajtuar atë me një kujdes e vëmendje të veçantë. Realiteti ka folur në vazhdimësi që veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje janë kthyer në një fenomen që kërkon vëmendjen e gjithë shoqërisë. Kjo ka qenë arsyeja që menduam të trajtojmë në këtë manual, dhunën në familje:

- si një fenomen antiligjor që kërkon vëmendje për zbatimin e procedurave standarde nga punonjësit e policisë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, kur ata përballen me raste të ushtrimit të dhunës në familje.
- si një fenomen social që ka tërhequr madje edhe vëmendjen e organizmave ndërkombëtare e që trajtohet prej tyre si shkelje e të drejtave të njeriut,
- si një fenomen që ka qenë dhe mbetet në qendër të vëmendjes nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile në vend.

Manuali e trajton dhunën në familje si shkelje e të drejtave themelore të njeriut. Në të përmenden disa nga standardet ndërkombëtare dhe shqiptare që e trajtojnë këtë problem dhe ofrohen disa të dhëna për shtrirjen gjeografike të dhunës në familje në vitet e fundit.

Në vitin 2006, me nismën e disa organizatave joqeveritare, mbështetur nga mbi 20 000 zgjedhës, Kuvendi miratoi ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili hyri në fuqi më 1 qershor 2007. Ligji, ndër organet e tjera, ngarkon me detyra Ministrinë e Brendshme dhe strukturat e Policisë së Shtetit.

Nëpërmjet këtij manuali mendojmë të japim një informacion të nevojshëm dhe të sqarojmë, se si duhet të kuptohen e zbatohen kërkesat e këtij ligji nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

Manuali trajton procedurat standarde që duhet të zbatojë punonjësi i policisë kur përballen me një rast që ka të bëjë me ushtrim të dhunës në familje dhe masat mbrojtëse që duhet të marrë për viktimën e dhunës në familje dhe zbatimin e urdhërave të mbrojtjes.

K R E U I

DHUNA NË FAMILJE - SHKELJE E TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT

Të drejtat e njeriut janë të drejtat që çdo qenie njerëzore ka dhe ka të drejtë t'i gëzojë, thjesht nga virtyti i të qenit njerëzor. Ato janë mbështetur në parimin themelor që të gjitha qeniet njerëzore zotërojnë një dinjitet të brendshëm dhe se ato janë të barabarta, të autorizuar për të gëzuar të drejtat e tyre, pavarësisht seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, origjinës kombëtare, moshës, klasës ose besimit fetar a politik.

Të drejtat e njeriut kanë qenë formuluar në norma ligjore të detyrueshme që mbrojnë individët dhe grupet kundër veprimeve që çenojnë dinjitetin njerëzor dhe liritë themelore. Dokumentet themelore janë quajtur Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut dhe konsistojnë në: Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (UDHR), konventën ndërkombëtare "Për të drejtat civile dhe politike" (ICCPR) dhe konventën ndërkombëtare "Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore" (ICESCR).

Në thelb të konceptit të të drejtave të njeriut është respekti për dinjitetin njerëzor dhe vlerën e çdo personi. Ky koncept është reflektuar në marrëdhënien midis çdo personi dhe shoqërisë në të cilën duhet të sigurohen vlera të qëndrueshme dhe universale. Në këtë kontekst, të drejtat e individëve janë njohur përkundëjt shoqërisë së tyre. Përmbajtja kryesore e të drejtave të njeriut i referohet gëzimit të një numri garancish që përbëjnë të drejtën dhe që kanë karakteristikat e saj universale. Përmbajtja kryesore minimale është e panegociueshme dhe u përket të gjithë individëve, në të gjitha kontekstet dhe në të gjitha rrethanat. Ajo tregon një nivel minimal nën të cilin nuk duhet të veprojë asnjë shtet.

Të drejtat e njeriut nënkuptojnë dy nivele marrëdhëniesh:

- **Marrëdhënien midis individëve**, në të cilën respekti i çdo të drejte përbën detyrë thelbësore,
- **Marrëdhënien midis individëve dhe shtetit**, në të cilën shteti ka për detyrë të respektojë, të mbrojë dhe të sigurojë përmbushjen e të drejtave sipas së drejtës së çdo individi dhe grupi në shoqëri.

Në traktatet dhe marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare gjenden tri mënyra të ndryshme të përshkrimit të këtyre detyrimeve:

1. **Detyrimin për të respektuar (detyrim negativ)**, p.sh.: nuk duhet të torturojë, nuk duhet të tolerojë gjykime të padrejta, duhet të shmangë diskriminimin e bazuar në seks).
2. **Detyrimin për të mbrojtur (detyrim pozitiv)**, p.sh.: krijimi i strehëzave për viktimat të dhunës në familje (gra, femije, etj), sigurimi i shërbimeve shëndetësore për viktimat, mbështetja me fonde e shërbimeve sociale që

merren me problemin e dhunës në familje, ofrimi i trajnimeve për policinë për të adresuar dhunën në familje).

3. **Detyrimin për të përmbushur (detyrim pozitiv)**, kërkon marrjen e masave të duhura për të siguruar realizimin e standardeve të të drejtave të grave, p.sh.- sigurimi i mjeteve ligjore për t'u ankuar ndaj një gjykimi të gabuar, garantimi i aksesit për viktimat e dhunës në familje në shërbimet sociale dhe kujdesin shëndetësor.

Në fushën e dhunës në familje kjo do të thotë se një shtet ka përgjegjësi jo vetëm për të ndaluar dhunimin e të drejtave njerëzore (të grave, të femijeve, çdo personi tjetër të dhunuar në marrëdhëniet familjare), por edhe për marrjen e masave aktive për parandalim dhe mbrojtje. Një shtet është i detyruar të sigurojë që dhuna në familje nuk ndodh dhe nëse ajo ndodh, është detyrë e tij të sigurojë mbrojtjen e viktimave.

Detyrimet e një shteti përfshijnë:

- Detyrimin **për të vepruar** që përfshin, si marrjen e veprimeve, ashtu edhe abstenimin nga veprimet.
- Detyrimin **për të arritur rezultate konkrete**, që do të thotë përmbushja e një rezultati të veçantë, përmes zbatimit aktiv të programeve dhe të politikave.

Një shtet duhet të arrijë disa rezultate në zbatimin e të drejtave njerëzore dhe eliminimin e diskriminimit dhe dhunës në marrëdhëniet familjare (dhunës kundër gruas, femijeve, prindërve, personave me paaftesi, etj.)

Në shoqërinë shqiptare dhuna në familje shfaqet në të gjitha format e saj deri në ekstrem, si vrasja e bashkëshortëve, prindërve apo femijeve. Gjithnjë e me shumë ky problem po bëhet më i ndjeshëm për mbarë opinionin, por institucionet deri tani kishin një zbrastësi legjislativ, ku mund të mbështetej puna parandaluese apo ndalimi forcërisht i këtyre fenomeneve.

Me nismën e shoqërisë civile, u bë i mundur hartimi dhe miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i cili përbën një mjet më shumë në dispozicion të institucioneve për të siguruar mbrojtje për viktimat.

K R E U II

STANDARTET NDERKOMBETARE DHE SHQIPTARE PER DHUNEN NE FAMILJE

1. Standardet ndërkombëtare për dhunën në familje.

Në ditët tona, standardet ligjore ndërkombëtare ndalojnë qartë dhunën në familje, si dhunim i të drejtave njerëzore kryesore dhe lirive themelore, të mëposhtme, të garantuara nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut për të gjithë individët:¹

1. E drejta për barazi²
2. Liria nga diskriminimi³
3. E drejta e jetës, lirisë dhe sigurisë personale⁴
4. Liria nga tortura dhe trajtimet mizore, çnjerëzore ose poshtëruese⁵
5. E drejta e njohjes si një person para ligjit⁶.
6. E drejta për barazi përpara ligjit⁷
7. E drejta për mjete juridike nga gjykata kompetente⁸
8. E drejta për barazi në familje⁹
9. E drejta për standardin më të lartë të arritshëm, për shëndetin fizik dhe mendor¹⁰

Të gjitha të drejtat njerëzore dhe liritë e listuara njihen gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR): “Çdo njeri gëzon të drejtën e rendit shoqëror dhe ndërkombëtar, në të cilin të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë deklaratë mund të realizohen plotësisht.”¹¹

Shumica e dispozitave të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut janë bërë detyruese, si pjesë e së drejtës. Vendet veprojnë sikur dispozitat e saj të ishin ligj, duke e bërë kështu UDHR-në një ligj. Shumë vende kanë integruar të drejtat njerëzore të sipërpërmendura në dispozitat e tyre kushtetuese, duke garantuar kështu lirinë e individeve pamvaresisht nga gjinia apo mosha e tyre, nga dhuna në familje. Si ligj suprem i një shteti, një kushtetutë deklaron vlerat më të thella të shtetit dhe deklarata e shtetit që abuzimi i grave cënon vlerat e tij më të thella, është e rëndësishme. Gratë duhet t'i përdorin këto deklarata kushtetuese për të bërë presion

¹ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR), miratuar dhe shpallur nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 217A(III) e 10 dhjetorit 1948

² Po aty, neni 1

³ Po aty neni 2

⁴ Po aty neni 3

⁵ Po aty neni 5

⁶ Po aty, neni 6

⁷ Po aty neni 7

⁸ Po aty neni 8

⁹ Po aty neni 16

¹⁰ Po aty neni 26

¹¹ Po aty, neni 28

për ndryshime legislative dhe për të kërkuar dëmshpërblim për dështimin e shtetit në mbrojtje të grave në familje.

Normat dhe direktivat ndërkombëtare në lidhje me dhunën në familje, ekzistojnë në tri nivele të ndryshme:

- Kombet e Bashkuara (KB),
- Këshilli i Europës (KE)
- Bashkimi Evropian (BE).

A. Niveli i Kombeve të Bashkuara

Dokumentet e Kombeve të Bashkuara kanë të bëjnë me njohjen e dhunës në familje, si dhunim i të drejtave njerëzore sipas së drejtës ndërkombëtare dhe formë e diskriminimit kundër grave, si edhe njohjen e përgjegjësisë së një shteti për aktet private të dhunës kundër grave. Këto dokumente janë të tipave të ndryshëm dhe fuqia e tyre ndryshon nga detyruese në jodetyruese ligjrisht.

Megjithatë, pavarësisht nivelit të tyre detyrues, koleksioni i dokumenteve të Kombeve të Bashkuara në këtë fushë ka ndikim të fortë në zgjerimin e së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e grave.

Normat detyruese ligjore të Kombeve të Bashkuara:

- Konventa ndërkombëtare “Për të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore”, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991.
- Konventa ndërkombëtare “Për të drejtat civile dhe politike”, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991.
- Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave” (CEDAW).¹²

CEDAW konsiderohet si një kartë ndërkombëtare e të drejtave të grave. Ajo përcakton diskriminimin në një mënyrë shumë të qenësishme, duke bërë të qartë që *gratë kanë të drejtën e një gëzimi të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të tyre njerëzore*. CEDAW, synon të sigurojë barazinë, si detyrim parësor për shtetet palë (neni 2) dhe përmirësimin de facto të pozitës së grave (neni 3-24) duke nënkuptuar veprime pozitive. Ajo lufton ideologjinë gjinore sunduese (neni 5.a) duke kërkuar një ndryshim të qëndrimit tradicional ndaj gruas, që pengon gratë në realizimin e të drejtave të tyre (duke përfshirë eliminimin e stereotipave gjinorë të fshehur në legjislacion). Ndonëse vetë teksti i Konventës nuk shprehet drejtpërdrejt për dhunën ndaj grave, **rekomandimi nr. 19**, i përpunuar nga Komiteti i CEDAW-t, një organ i krijuar nga vetë Konventa, është shprehur se Konventa duhet

¹² CEDAW është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.7767, datë 9.11.1993 dhe ka hyrë në fuqi, më 11 maj 1994. Me ligjin nr. 9052, datë 17.4.2003, Republika e Shqipërisë aderon edhe në Protokollin Shtesë të Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”.

interpretuar në mënyrë të tillë që të përfshijë edhe dhunën me bazë gjinore në dispozitat dhe detyrimet që krijon.

Konventa “Mbi të drejtat e fëmijës”, (edhe kjo e ratifikuar nga Shqipëria) në nenin 19 të saj parashikon: “Fëmijët kanë të drejtë të mbrohen nga lëndimet dhe keqtrajtimet fizike e psikologjike. Qeveritë duhet të sigurojnë që fëmijët të jenë nën kujdes të përshtatshëm dhe t’i mbrojnë ata prej dhunës, abuzimit dhe neglizhimit të prindërve ose të kujtdo tjetër që kujdeset për ta...”

➤ **Normat e politikës së Kombeve të Bashkuara: Deklarata “Për eliminimin e dhunës kundër grave”**

Deklarata “Për eliminimin e dhunës kundër grave” (DVAW), miratuar në vitin 1993, e përcakton kështu dhunën ndaj gruas: “Dhunë ndaj grave është dhuna me bazë gjinore që sjell ose mund të sjellë si pasojë dëmtimin ose vuajtjen fizike, seksuale apo psikologjike të gruas, përfshi edhe kërcënimet për kryerjen e veprave të tilla, shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirive, që ndodhin si në jetën publike ashtu dhe në jetën private”. Deklarata pranon se dhuna me bazë gjinore mund të ndodhë në familje. DVAW specifikon veprimet që duhet të ndërmerren një shtet për të eliminuar dhunën që ndodh në sferën private: të hartojë legjislacionin e duhur penal; të zhvillojë plane kombëtare të veprimit për të eliminuar dhunën kundër grave, në bazë të burimeve që disponon; të sigurojë shërbime sociale për gratë-viktima të dhunës; të marrë masa për të siguruar trajnimin e zyrtarëve publikë të cilëve u është besuar zbatimi i ligjeve, për t’i bërë ata të ndjeshëm ndaj nevojave të grave; të sigurojë që në buxhetin e qeverisë të caktohen burime të mjaftueshme për të luftuar dhunën në familje. DVAW bën të qartë se veprimi i shteteve palë duhet të matet kundrejt standardeve ndërkombëtare që artikulojnë qartë një strategji për eliminimin e dhunës kundër grave në familje.

B. Niveli i Këshillit të Europës

Këshilli i Europës (KE), si organizatë ndërqeveritare rajonale, ka drejtuar vëmendjen nga mbrojtja e të drejtave njerëzore, që nga themelimi, në vitin 1948. Aktualisht, ai përfshin 46 shtete anëtare. Sistemi i të drejtave të njeriut të Këshillit të Europës është bazuar në traktatet, të cilat përcaktojnë detyrimet për shtetet anëtare dhe dokumente jodetyruese, si: direktiva, rekomandime dhe rezoluta. Traktatet e të drejtave të njeriut të Këshillit të Europës janë:

- ◆ Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa Europiane), që u miratua në vitin 1950 dhe hyri në fuqi në 1953; është ratifikuar nga Shqipëria dhe ka hyrë në fuqi më 2 tetor 1996.
- ◆ Karta Sociale Europiane (1965)
- ◆ Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës, të Trajtimeve ose Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese 1989; është ratifikuar nga Shqipëria dhe ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 1997.

Konventa Europiane ka peshë të veçantë për shtetet anëtare. Ratifikimi i saj përbën një kusht politik de facto për t’u anëtarësuar në Këshillin e Europës. Të gjitha

shtetet anëtare të KE-së duhet ta përfshijnë Konventën Europiane në legjislacionin kombëtar. Konventa ka efekt të drejtpërdrejtë në legjislacionin kombëtar dhe në këtë mënyrë, gjyqësori, në nivel kombëtar, mund dhe duhet të marrë në konsideratë dispozitat e kësaj Konvente.

C. Niveli i Bashkimit European

BE-ja e adreson barazinë gjinore përmes një numri direktivash, rezolutash, rekomandimesh dhe aktesh, të nxjerra nga Këshilli i Bashkimit European, Komisioni European dhe Parlamenti European.

Në vitin 1986, Parlamenti European miratoi rezolutën “Për dhunën kundër grave” Ajo bëri thirrje për njohjen ligjore të përdhunimit martesor, për organizimin e trajnimeve për ata që mund të jenë në kontakt me viktimat e dhunës në familje, dhe rekomandoi që grave t’u sigurohet asistencë ligjore.

Në vitin 1997, Parlamenti European miratoi rezolutën për nevojën për të ndërmarrë një fushatë të gjerë të BE-së për tolerancë “zero” ndaj dhunës kundër grave.

Presidenca e BE-së, çështjen e dhunës në familje e ka vendosur në axhendën politike që prej vitit 1998 dhe ka miratuar një numër rekomandimesh që trajtojnë kryesisht dhunën në familje.

Në konferencën e BE-së për dhunën kundër grave, të mbajtur me 1999, u krijuan pesë forume ekspertesh për të shqyrtuar aspekte të caktuara të dhunës në familje: përmbajtjen, shkaqet e fshehura dhe pasojat, mundësitë ligjore për të luftuar dhunën në familje, parandalimin, ndihmën për organizatat dhe bashkëpunimin me institucionet dhe rrjetet europiane dhe punën me dhunuesit. Konferenca miratoi rekomandimin e forumeve të eksperteve për shtetet anëtare.

Mbledhja e ekspertëve të BE-së për dhunën kundër grave, e mbajtur në vitin 1999, dha rekomandime për modele të përbashkëta për veprim në ndihmë të luftës kundër dhunës.

Ka përpjekje, për të bërë të mundur, që lufta ndaj dhunës në familje të jetë kriter për anëtarësim në të ardhmen.

2. Standardet ligjore shqiptare për dhunën në familje

Aktet normative për mbrojtjen nga dhuna në familje.

2.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është akti ligjor më i lartë, i cili sanksionon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, si parim përshtues i të gjithë legjislacionit. Ajo i ka hapur rrugë zhvillimit të së drejtës së brendshme në përfaqesje me standardet ndërkombëtare.

Normat ndërkombëtare kanë ndikim shumë të rëndësishëm në sistemin ligjor dhe politikat kombëtare të shtetit tonë. Kushtetuta¹³ parashikon se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”. Kurse, në ndërtimin e hierarkisë normative, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara¹⁴, i ka dhënë fuqi ligjore. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë, pasi botohen në Fletoren Zyrtare, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik¹⁵. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë¹⁶. Në terminologjinë e Kushtetutës shqiptare nuk ka kategorizime apo “etiketime gjinore”. Në këtë dokument të rëndësishëm përdoren përemra të tillë, si: “të gjithë, “kushdo”, “askujt”, “kujtdo”, “secili” etj. dhe kjo për të treguar se bashkësia njerëzore së cilës i drejtohet dispozita, nuk bën asnjë përjashtim.

I gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit. Gjithashtu, mbrojtja dhe respektimi i dinjitetit, i të drejtave dhe i lirive të njeriut përbëjnë detyrim kushtetues. Jeta, martesë, familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ana e shtetit. Kushtetuta nuk e përjashton mbrojtjen e familjes edhe në rastet kur nuk është e krijuar me martesë. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.

Duke konsideruar faktin se koncepti i torturës dhe i trajtimeve mizore, çnjerëzore apo poshtëruese së fundmi është zgjeruar dhe konceptohet jo vetëm si akt i kryer nga persona të veshur me funksion zyrtar, por edhe nga individë, dhe shteti është përgjegjës për mbrojtjen e qytetarëve nga trajtime të tilla, Kushtetuta ofron mbrojtje ndaj dhunimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të gruas në mënyrë të veçantë duke përcaktuar: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruës”.¹⁷

Kushtetuta, që në pamje të parë duket sikur ofron vetëm dispozita deklarative, ka krijuar mekanizma garantues të përgjithshëm për mbrojtjen nga dhuna, te tilla si: Avokati i Popullit, sistemi gjyqësor, Gjykata Kushtetuese.

Permendja e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Kushtetuta u hap rrugë garancive juridiksionale ndërkombëtare. Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mund t’i paraqiten kërkesa nga çdo person, organizëm joqeveritar ose grup individësh që pretendojnë se janë të dëmtuar nga ndonjë shkelje e shtetit shqiptar e të drejtave të njohura nga Konventa ose protokollet e saj.

¹³ Kushtetuta e RSh neni 5

¹⁴ Po aty neni 116

¹⁵ Po aty neni 122

¹⁶ Po aty neni 18/2

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 25

Ligjet.

Legjislacioni shqiptar për dhunën në familje përbëhet nga dispozita procedurale dhe materiale të parashikuara në:

1. Kodin Penal
2. Kodin e Procedurës Penale
3. Kodin e Familjes, si dhe
4. Ligjin për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare

Kodi Penal parashikon dispozita për sa i përket trajtimit të veprave penale, përfshirë këtu vrasjen, plagosjen, dëmtime të tjera me dashje, marrëdhëniet seksuale me dhunë, etj.

Kodi Penal dhunën në familje nuk e përmban si figurë të veçantë të veprës penale. Megjithatë, si rrethanë rënduese, ai parashikon çdo vepër penale që kryhet ndaj fëmijëve, grave shtatzëna, personave me paaftësi, përsëritjen e dhunës në familje në mënyrë sistematike, ose veprën që kryhet duke përfitur nga marrëdhëniet familjare.

Si vepra penale të përcaktuara në Kodin Penal që kanë të bëjnë me dhunën në familje përmendim:

- Vrasja (Nenet 76 – 83, 85 të Kodit Penal)
- Kanosja (Neni 84)
- Tortura (Nenet 86 dhe 87)
- Plagosja e rëndë me dashje (Neni 88, 88/a, 88/b)
- Plagosja e lehtë me dashje (Neni 89)
- Dëmtime të tjera me dashje (Neni 90)
- Plagosja e rëndë nga pakujdesia (Neni 91)
- Plagosja e lehtë nga pakujdesia (Neni 92)
- Ndërprerja e shtatëzanisë pa pëlqim të gruas (Neni 93)
- Shkaktimi i vetëvrasjes (Neni 99)
- Marrëdhënie seksuale (Nenet 100-107)
- Vepra të turpshme (Neni 108)
- Rrëmbimi (Neni 109, 109/a, 109/b)
- Heqja e paligjshme e lirisë (neni 110)
- Trafikimi (Neni 110/a)
- Dhunimi i banesës (Neni 112)
- Prostitucioni (Neni 113)
- Shfrytëzimi i prostitucionit (nenet 114, 114/a 114/b)

- Fyerja (Neni 119)
- Shpifja (Neni 120)
- Ndërhyrje të padrejta në jetën private (neni 121)
- Përhapja e sekreteve vetjake (neni 122)
- Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës (neni 123)
- Braktisja e fëmijëve të mitur (Neni 124)
- Mosdhënia e mjeteve për jetesë (Neni 125)
- Marrja e padrejtë e fëmijës (Neni 127)
- Trafikimi i të miturve (neni 128/a)
- Shtytja e fëmijëve në krim (neni 129)
- Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë (Neni 130)
- Kufizimi i lirisë për të administruar të ardhurat (vjedhja me dhunë/vjedhja – (Nenet 134, 137, 139, 140, 141)
- Mashtrimi (neni 143)
- Shkatërrimi i pronës (Nenet 150-154)
- Prishje e qetësisë publike (neni 274)
- Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (Neni 275)
- Vetgjyqësia (neni 277)

Disa nga këto vepra do të trajtohen më me hollësi në kreun IV të këtij materiali.

Kodi i Procedurës Penale. Në pjesën më të madhe të veprave penale Kodi i Procedurës Penale, parashikon ndjekjen penale nga organet shtetërore (Prokuroria), mirëpo një sërë veprash të tjera penale, të një rrezikshmërie shoqërore më të vogël ndiqen me ankim nga individ i dëmtuar. Kështu për veprat penale të një rëndësie më të vogël, të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale, i dëmtuari ka të drejtën e ngritjes së akuzës dhe merr pjesë në gjykim si palë, prandaj quhet i dëmtuari akuzues.

Disa nga veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje, hyjnë në kategorinë e veprave që ndiqen me ankim, drejtpërdrejt në gjykatë, nga i dëmtuari akuzues. Nëpërmjet këtyre dispozitave, ligjvënësi i jep mundësi personit të dëmtuar të fillojë procesin penal dhe ta ndjekë atë, për veprat penale që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të dhe me të drejtat personale të tij. Kjo mundësi i jepet të dëmtuarit për vepra penale të konsideruara me rrezikshmëri shoqërore të ulët.¹⁸ Të tilla janë edhe këto

¹⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 59/1

nene të Kodit Penal, të cilat, siç u përmendën më lart, ka të ngjarë të ndodhin edhe në kuadrin e marrëdhënieve familjare:

- Dëmtime të tjera me dashje (Neni 90)
- Plagosja e rëndë nga pakujdesia (Neni 91)
- Plagosja e lehtë nga pakujdesia (Neni 92)
- Dhunimi i banesës (Neni 112)
- Fyerja (Neni 119)
- Shpifja (Neni 120)
- Ndërhyrje të padrejta në jetën private (neni 121)
- Përhapje e sekreteve vetjake (neni 122)
- Mosdhënia e mjeteve për jetesë (Neni 125)
- Marrja e padrejtë e fëmijës (Neni 127)

Kodi i Familjes, ka hyrë në fuqi në vitin 2004. Ai përshkohet nga parimi se martesë dhe familja mbështeten në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve. Ato gëzojnë mbrojtje të veçantë të shtetit. Ky Kod, solli disa dispozita të reja, të cilat mbrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e bashkëshortit të dhunuar. Duke konsideruar faktin se në një pozitë të tillë ndodhet shpesh gruaja, mbrojtja që këto dispozita sigurojnë, është e rëndësishme për të. Kështu, neni 63 parashikon për herë të parë masa urgjente kundër dhunës bashkëshortore dhe në mbrojtje të familjes, duke detyruar dhunuesin të largohet nga banesa bashkëshortore për një periudhë 3-vjeçare.

Në legjislacionin shqiptar nuk parashikohet kompensim i veçantë për viktimat e dhunës në familje. Megjithatë, ka dispozita të përgjithshme që mund të zbatohen në këto raste.

Ligji nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ka si qëllim (neni 1 i ligjit) parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ky ligj do të trajtohet më gjerësisht më poshtë.

Krahas legjislacionit kryesor, ka edhe një sërë ligjesh të tjera që mund të ofrojnë mbështetje për një luftë të gjithanshme ndaj dhunës me bazë gjinore, përfshi edhe dhunën në familje, si p.sh.: **Ligji nr. 9198, datë 1.7.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri”**, i cili synon të sigurojë realizimin e të drejtave të barabarta të grave dhe burrave, të garantuara në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të përcaktojë masa për të eliminuar diskriminimin gjinor të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në jetën publike të vendit dhe të përcaktojë përgjegjësitë e administratës

qendrore dhe vendore për të hartuar politika për përkrahjen e një shoqërie gjinore të barabartë.

2.3 Strategjitë dhe Planet e veprimit për parandalimin e dhunës në familje.

Qeveria shqiptare, me mbështetjen e disa organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve të ndryshme ka hartuar disa strategji që mund të gjejnë zbatim dhe janë në funksion të parandalimit të dhunës në familje si:

2.3-a. **Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit për barazine gjinore dhe dhunën në familje**, e cila përcakton politikat dhe veprimet konkrete të strukturave, përfshi edhe organet e policisë për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës në familje.

2.3-b. **Strategjia e Shërbimeve Shoqërore, 2005-2010**, që ka Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta – Drejtoria e Shërbimeve Sociale. Ky dokument u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr.265, datë 28.4.2005. Në kuadër të kësaj strategjie janë evidentuar grupe kryesore të individëve që kanë nevojë për mbështetje dhe shërbime sociale. Një prej tyre janë gratë ku, përveç grupeve të tjera, përfshihen: gratë e dhunuara (viktima të dhunës në familje) dhe gratë e divorcuara.

2.3-c. Strategjia kombëtare për zhvillimin social dhe ekonomik

Kjo strategji synon zbatimin e politikave sociale zbutëse të varfërisë. Ajo vë theksin tek siguri i shërbimeve të veçanta që do t'u ofrohen kategorive të prekshme të popullsisë (fëmijëve, të rinjve, grave, të moshuarve) për t'iu përgjigjur nevojave të tyre. Strategjia nuk përmend në mënyrë të veçantë dhunën në familje dhe nuk parashikon politika mbrojtëse, por i shërben parandalimit të saj.

2.3-d. Strategjia e punësimit dhe e formimit profesional

Në kuadrin e kësaj strategjie parashikohen të aplikohen programe për gratë e papuna dhe me probleme të thella sociale, e cila i shërben parandalimit të dhunës së mëtejshme në familje.

2.3-e. Strategjia kombëtare shqiptare për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore: kuadri strategjik dhe plani kombëtar i veprimit, 2005-2007.

Kuadri strategjik dhe plani kombëtar i veprimit, 2005-2007, e konsideron dhunën në familje si shkak të trafikimit dhe me aktivitetet e parashikuara në këtë kuadër, mendohet që kanë ndikuar edhe mbi dukurinë e dhunës kundër grave dhe fëmijëve. Mbështetja nga qeveria e programeve të ndryshme për arsimin, shtypin dhe mënyrat e tjera të informimit të komunitetit e sidomos të grave, fëmijëve e grupeve në rrezik rreth trafikimit, përbën një objektiv specifik të këtij kuadri strategjik. Kjo strategji së fundmi është në proces rishikimi dhe rinovimi për të mbuluar periudhën në vazhdim.

2.3-f. Strategjia dhe Plan i veprimit “Për veprimtarinë e Policisë së Shtetit për periudhën 2007-2013”, ku përcaktohen synimet e objektivat që

do të arrijë Policia e Shtetit në kuadrin e policimit në komunitet dhe parandalimin e goditjen e krimit. Po ashtu përcaktohet dhe ngritja e strukturave të reja për herë të parë, të cilat do të merren direkt me parandalimin e trajtimin e dhunës në familje, si dhe mbrojtjen e të miturve.

K R E U III

KUPTIMI MBI DHUNËN NË FAMILJE NË SHQIPËRI

1. C'është dhuna në familje – përkufizimi.

Dhunën në familje, veç përkufizimit që i jep Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, cituar më lart, ligji shqiptar e përkufizon: “çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër që sjell si pasojë cënimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare”.

Në shumicën e rasteve dhuna drejtohet:

- ndaj grave brenda çiftit,
- ndaj fëmijëve nga prindërit,
- midis vetë fëmijëve,
- nga fëmijët drejtuar prindërve
- ndaj të moshuarve.
- ndaj personave me paaftësi.

2. Përmasat e dukurisë së dhunës në familje.

Përmasat e përhapjes së dukurisë së dhunës në familje në vendin tonë është e vështirë të përlogariten.

Ka materiale studimore për dhunën në familje, të organizuara, zhvilluara e botuara nga OJF të ndryshme dhe kryesisht ato të grave. Studimet e tyre përmbajnë përfundime të sondazheve me përmasa të kufizuara për sa i përket shtrirjes gjeografike, kampionëve të përzgjedhur, gjë që e bën shumë të vështirë nxjerrjen e konkluzioneve përgjithësuese për përmasat e dukurisë së dhunës në familje në Shqipëri.

Po ashtu dhe mosparashikimi i dhunës në familje si vepër penale e veçantë në legjislacionin penal dhe, si pasojë, regjistrimi i një akti dhune në familje, si dhunë e një personi çfarëdo ndaj një tjetri, ka ndikim negativ në grumbullimin e statistikave të plota dhe të besueshme.

Fakti që dhuna në familja është një problem shumë i madh në Shqipëri, tërthorazi pohohet edhe nga numri i grave që kanë kryer krime ndaj bashkëshortit. Përballë dhunës së vazhdueshme të ushtruar nga bashkëshortët e tyre, ato nuk janë përmbajtur dhe i kanë vrarë ata, edhe pse krimi është i pajustificueshëm. Në botimin “Monitorimi i shtypit mbi dhunën në familje, 2001-2002”, autorët paraqesin një shifër prej 90 për qind të grave të cilat vuajnë dënimin në burgun 313 në Tiranë për arsye se kanë vrarë bashkëshortët e tyre, pasi për vite me radhë kanë qenë pre e dhunës fizike dhe seksuale.

Kjo e dhënë vërtetohet edhe nga studimi i kryer nga shoqata *Përthyerja*. Nga të dhënat e këtij studimi rezulton se shumë nga këto gra e vajza nuk kanë qenë dënuar

më parë dhe se krimet e kryera, në shumicën e rasteve, kanë ardhur nga dhuna. 70 për qind e tyre kanë përjetuar dhunë fizike dhe 30 për qind abuzim seksual.


Në një studim të realizuar nga Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare në vitin 2004, në 9 rrethe të Shqipërisë u plotësuan 1895 pyetësorë dhe 85.17 për qind e të anketuarve kanë pohuar ekzistencën e dhunës në familje

Shifrat flasin qartë për përmasat e shtrirjes së dhunës në familje në Shqipëri. Po kështu, të dhënat tregojnë se kjo dhunë nuk është e shtrirë vetëm në zonat rurale, por edhe në qytete, madje edhe në qytetet kryesore të Shqipërisë.

Të dhënat statistikore të Policisë së Shtetit për vitin 2005 dhe 2006 flasin për këtë shtrirje gjeografike të veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje:

Nr.	Drejtoritë Policisë në qarqe	Viti 2005	Viti 2006	Të dy vitet
1	Tiranë	29	96	125
2	Durrës	10	34	44
3	Fier	7	10	17
4	Vlorë	10	8	18
5	Gjirokastrë	2	2	4
6	Korçë	5	9	14
7	Berat	6	9	15
8	Elbasan	8	8	16
9	Lezhë	6	5	11
10	Shkodër	5	20	25
11	Kukës	4	3	7
12	Dibër	2	4	6
13	Totali	94	208	302

Siç vihet re, statistikat e vërtetojnë një rritje shqetësuese të rasteve të dhunës në familje. Ndonëse ato mund të jenë të ndikuara nga fakti se dhuna në familje tashmë denoncohet më shumë si rezultat i ndërgjegjësimit të viktimave, gjithsesi shifrat janë alarmante dhe kërkojnë angazhim maksimal nga strukturat policore.



Paraqitje grafike në përqindje për cdo qark.¹⁹

Kjo dukuri nuk kishte si të kufizohej, përderisa migrimi i brendshëm ka prekur të gjithë vendin. Nga përzierja e popullsisë, problemet social-ekonomike dhe përplasja e nënkulturave të ndryshme i nxorën më me forcë në sipërfaqe problemet e dhunës. Kjo dukuri lypset të bëhet objekt studimesh për të njohur jo vetëm gjendjen dhe shkallën reale të dhunës në familje, por dhe për të përcaktuar më drejt rrugët dhe mjetet e nevojshme për kufizimin e saj. Policia e Shtetit nga viti 2005 e në vazhdim ka evidentuar me statistika të veçanta veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje, si më poshtë:

Veprat penale për dhunën në familje: viti 2005, 2006 dhe gjashtë-mujori i parë 2007:

Veprat penale	Viti 2005	Viti 2006	Gjashtë-mujori parë 2007	Total
Vrasje neni 76	16	20	9	45
Kanosje neni 84	15	55	44	114
Tentativë vrasjeje neni 76 e 22	8	23	7	38
Plagosje e lehtë me dashje neni 89	18	36	16	60
Dëmtime të tjera me dashje neni 90	23	49	20	92
Shkaktim vetëvrasje Neni 99	1	2	6	9
Krime seksuale Neni 102	2	2	5	9
Ndërprerje e shtatzanisë neni 93	1	1	0	2
Shtyrje në prostitucion Neni 110/a	0	1	0	1
Shtrengim për bashkëjetesë Neni 130	3	5	1	9

¹⁹ Në grafikën e mësipërme, janë paraqitur:


- o Shpërndarja sipas qarqeve të numrit të veprave penale që kanë lidhje me dhunën në familje, për vitin 2005 dhe vitin 2006.
- o Përqindja për cdo qark të veprave penale që kanë lidhje me dhunën në familje, duke i'u referuar kolonës që përmban shifrat e numrit për të dy vitet. Siç vihet re, më tepër dhuna në familje është e përhapur në qarqet Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë e Fier.

Vjedhje banese Neni 34	2	9	6	17
Dëmtim prone Neni 150-154	5	5	5	15
Vepra të tjera penale	0	0	3	3
Totali	94	208	122	424

Siç vihet re statistikat evidentojnë faktin se ndër veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje, më të përhapura janë kanosjet, dëmtimet të tjera me dashje (rrahjet), plagosjet e lehta me dashje, vrasjet dhe tentativat për vrasje. Këto lloj veprash penale kërkojnë një vëmendje më të madhe për t'u vlerësuar nga punonjësit e Policisë së Shtetit që e kanë për detyrë të merren me trajtimin e tyre.

Viktimat e dhunës në familje sipas seksit.

Seksi	Viti 2005	Viti 2006	Gjashtëmujori i parë 2007	Totali
Femra	57	121	84	262
Meshkuj	37	87	38	162
Totali	94	208	122	424



Pra, siç vihet re, femrat preken në mënyrë disproporcionale nga dhuna në familje. Prandaj shpeshherë dhuna në familje shihet si një nga format e dhunës me bazë gjinore, pasi ajo ushtrohet ndaj gruas, pikërisht pse është grua.

3. Format e dhunës.

Format dhunës janë:

- Dhunë fizike,
- Dhunë psikologjike (ose emocionale),
- Dhunë seksuale
- Dhunë ekonomike.

3-a. Dhuna fizike përfshin: shtyrjen, goditjen, gërvishtjen, pickimin, kafshimin, hedhjen, mbylljen në shtëpi, goditjen me objekte të ndryshme, kërcënimin me thikë ose me armë tjetër, refuzimin për ta ndihmuar gruan kur ajo është shtatzënë ose

sëmurë, deri në formën më të rëndë – vrasjen, vrasjen e mbetur ne tentativë, plagosjen, etj.

Dhuna fizike është një formë dhune që viktimat e kanë më të lehtë për ta perceptuar dhe për ta pranuar për vetë natyrën e ushtrimit të saj dhe të gjurmëve të dukshme që ajo lë tek viktima.

3-b. Dhuna seksuale, përfshin: trajtimin e partneres (partnerit) si objekt seksual, detyrimin për të bërë striptizëm, detyrimin për të bërë seks, këmbënguljen për të prekur e për të bërë gjithçka dëshiron, detyrimin për të bërë seks me dikë tjetër, kryerjen e akteve seksuale sadiste, detyrimin e partneres të bëjë seks pas abuzimit fizik ose si kusht për të ruajtur marrëdhënien e tyre, kryerjen e marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore etj.

Është vërejtur se bashkëshortët apo partnerët që ushtrojnë këtë formë dhune, duan të demonstrojnë forcën dhe aftësinë e tyre për të sunduar dhe për të poshtëruar viktimën.

3-c. Dhuna Psikologjike, përfshin injorimin e ndjenjave të bashkëshortes, kritika të vazhdueshme, kundërshtim i vazhdueshëm i mendimeve, poshtërim në publik ose privatisht, përpjekje për ta bindur partneren se dhunën e meriton nga veprimet e veta, kërcënim i partneres për tradhëti bashkëshortore, shenja xhelozie të vazhdueshme, kërcënimin për marrjen e fëmijëve, mbajtje fshehur e parave, mbajtje në shtëpi pa punë, abuzim me fëmijët, thirrje me emra poshtërues etj.

Shumica e abuzimeve psikologjike ndodhin në kontekstin e formave të tjera të abuzimit, si ai verbal, ekonomik dhe izolimi social. Burrat që ushtrojnë abuzim fizik, zakonisht ushtrojnë edhe abuzim psikologjik. Dhuna psikologjike, për vetë natyrën e saj, është shumë e vështirë për t'u evidentuar, pasi nuk lë gjurmë të dukshme, si dhuna fizike, mirëpo sulmet verbale, poshtërimi, kërcënimi, kufizimi mund të jenë edhe më të dëmshme se sulmi fizik.

d. Dhuna ekonomike, ka të bëjë me kontrollin e partnerit mbi të ardhurat financiare të familjes apo edhe ndalimin e pjesëmarrjes së gruas në vendimet për shpenzimet e parave, madje edhe refuzimi i dhënies së parave për të mbuluar nevojat bazë të familjes, mohimi i pronësisë mbi pasurinë e përbashkët, dëmtim ose shkatërrim të pasurisë, vjedhje të pasurisë, etj.

Për vitet 2005-2006 dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2007 për format e dhunës në familje janë këto të dhëna statistikore²⁰

Format e dhunës	Viti 2005	Viti 2006	Gjashtë mujori i parë 2007	Totali
-----------------	-----------	-----------	----------------------------	--------

²⁰ Nxjerrë nga analizat vjetore e gjashtëmujore të Policisë së Shtetit. Më prezente në dhunën në familje është dhuna fizike. Kjo kërkon që punonjësit e policisë që trajtojnë dhunën në familje të kenë vlerësim më të madh e më të kualifikuar të rasteve që kanë të bëjnë me ushtrim të dhunës fizike në marrëdhëniet familjare.

Dhuna fizike	80	183	96	359
Dhuna psikologjike	5	9	10	24
Dhuna seksuale	2	2	5	9
Dhuna ekonomike	7	14	11	32
Totali	94	208	122	424

4. Pasojat e dhunës mbi viktimat

Ato mund të renditen në tri grupime:

4.1. Pasoja që lidhen me **shëndetin mendor**: depresion, frikë, ankth, mungesë vetëvlerësimi, anoreksi dhe pagjumësi, çrregullime pastraumatike, tentativa për vetëvrasje.

4.2. Pasoja që lidhen me **shëndetin fizik**: vdekje, paaftësi fizike e pjeshme apo edhe e përhershme, plagosje, abuzim me drogë dhe alkool, sindromë e irritimit të zorrëve, pirje duhani shkatërruese apo seks të pambrojtur.

4.3. Pasoja që lidhen me **shëndetin riprodhues**: shtatzëni të padëshiruara, probleme gjinekologjike, sëmundje seksualisht të transmetueshme, aborte, lindje nën peshë etj.

5. Disa faktorë që ndikojnë në dhunën në familje

Përkundër asaj çka flitet shpesh, dhuna në familje nuk shkaktohet nga sëmundjet, trashëgimia gjenetike, alkooli apo droga, humbja e vetëkontrollit, zemërimi, stresi, sjellja e viktimës apo problemet në marrëdhënie/në çift, por: *nga dëshira për të sunduar dikë, për ta pasur atë në dorë, për të vendosur e për të ushtruar pushtet e kontroll.*

Pra faktorët kryesorë të dhunës në familje kanë të bëjnë vetëm me pushtetin dhe kontrollin që kërkon të vendosë burri mbi gruan, prindi mbi fëmijën, persona të tjerë mbi personat me paaftësi.

Më poshtë po rendisim disa faktorë të tjerë (sekondarë) që mund ndikojnë në dhunën në familje dhe mund të klasifikohen në:

5.1. **Faktorë të nivelit makro**, ku përfshihen: ndikimi i kulturës, ekonomisë, politikës, lëvizjet e mëdha demografike etj.

5.2. **Faktorë të nivelit mikro** (familjar ose mikro), ku mund të përfshihen: marrëdhëniet në familje, modelet me të cilat janë rritur, edukata e familjes, mënyra e rritjes së fëmijëve etj.

5.3. **Faktorë të nivelit personal**, ku mund të përmendim: problemet e shëndetit mendor të individit, abuzimin me alkoolin, drogën, streset, nivelin kulturor, çrregullimet e ndryshme të personalitetit, përvojat personale në marrëdhëniet familjare etj.

6. Strukturat e posaçme të Policisë së Shtetit që merren me trajtimin e rasteve të dhunes në familje

Duke i vlerësuar veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje, për një trajtim ndryshe të tyre, nëpërmjet ligjit nr.9749 datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", me riorganizimin e strukturave, janë përcaktuar funksione të veçanta në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në Drejtoritë e Policisë në qarqe.

Në Departamentin për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë e Luftës Kundër Krimeve të Rënda është krijuar Sektori i mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje. Ky sektor ndjek në dinamikë veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Nëpërmjet analizës së fenomeneve, të të dhënave statistikore, ai nxjerr konkluzione, përcakton rrugëzgjdhje, përcakton masat që duhet të marrë Policia e Shtetit për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje si dhe për trajtimin e viktimave të saj.

Ky sektor bashkëpunon me sektorë të tjerë që trajtojnë problemet e dhunës në familje, si në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë si dhe me OJF të ndryshme që kanë objekt trajtimin e dhunës në familje dhe të viktimave të tyre. Ky bashkëpunim realizohet në shkallë vendi dhe konsiston në zhvillimin e analizave të përbashkëta, në trajnimin e punonjësve të policisë, etj. për të njëjtin qëllim – parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të kësaj dhune.

Në Drejtoritë e Policisë në qarqe pranë Sektorit të Luftës Kundër Krimeve të Rënda ka një specialist, i cili ndjek dinamikën e veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje në shkallë drejtorie e komisariati policie. Ai luan rolin e koordinatorit midis komisariateve, për trajtimin me profesionalizëm të veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe informon Sektorin e mbrojtjes së të miturve dhe dhunës në familje në Drejtorinë e Luftës Kundër Krimeve të Rënda në Departamentin e Hetimit të Krimeve. Ai bashkëpunon me organet lokale të shëndetësisë, të arsimit, të pushtetit vendor, të prokurorisë e gjykatat, si dhe me OJF që operojnë në territoret e tyre, për zhvillimin e analizave, takimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta, për të njëjtin qëllim – parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, trajtimin e viktimave të kësaj dhune në shkallë rajoni.

K R E U IV

KUPTIMI I DHUNËS NË FAMILJE SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL DHE LIGJIT NR.9669, datë 18.12.2006 “PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE”

Aktet ligjore për dhunën në familje në tërësinë e tyre përfshijnë detyrime institucionale për Policinë e Shtetit²¹ që rrjedhin nga Kodi Penal dhe Kodi i Proçedurës Penale si dhe nga ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Duhet mbajtur parasysh se këto ligje komplementojnë dhe nuk e zëvendësojnë njëri-tjetrin.

1. Kuptimi i përgjithshëm sipas ligjit 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, është një ligj me karakter administrativ-civil e jo penal. Ai funksionon si një mjet më shumë krahas Kodit Penal. Sipas rastit, Policia e Shtetit do të veprojë dhe në bazë të Kodit Penal dhe Kodit të Proçedures Penale, por edhe në bazë të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, për të njëjtin qëllim: parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, garantimin me masa mbrojtëse ligjore të viktimave të dhunës në familje.

Përkufizimi i dhunës në familje

Në kuptimin e nenit 3 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat:

“**Dhunë**”: do të kuptohet çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, dhe ekonomik.

“**Dhunë në familje**” është cdo akt dhune, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare;

“**Pjesëtarët e familjes**“ në kuptim të nenit 3, pika 3 të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, do të kuptojmë :

- Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja; apo ish–bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues;

²¹ Ligji nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”

- Vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar;
- Bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja i personave të parashikuar në shkronjën b të ligjit;
- Gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit edhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es;
- Vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit/es nëse kanë bashkëjetuar gjatë 3 (tre) muajve të fundit;
- Fëmijët e bashkëshortëve apo partnerëve bashkëjetues.

“**Viktima**” në rastet e ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare, janë personat mbi të cilët është ushtruar dhunë me veprim apo mosveprim nga një person tjetër, që ka sjellë si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, dhe ekonomik (neni 3, pika 4 e këtij ligji)

“**Dhunues/e**” në rastet e ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare është personi i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, përpara organeve kompetente, (neni 3, pika 5 e këtij ligji)

2. Kuptimi për dhunën në marrëdhëniet familjare në zbatim të legjislacionit penal, norma dhe procedura.

2.1. Përveç figurave të veprave penale të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë,²² do të konsiderohen dhunë në marrëdhëniet familjare edhe:

- Pengimi në mbajtjen e mjeteve monetare,
- Përçmimi në mënyra e forma të ndryshme,
- Abuzimi i drejtpërdrejtë fizik, psikologjik, seksual dhe ekonomik i fëmijëve,
- Vendosja e fëmijëve në situata të rrezikshme apo dëshmitarë të dhunës ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes.

2.2. Dispozita të Kodit Penal (kundër dhunës në marrëdhëniet familjare)

Kodi ynë Penal i jep vend të veçantë mbrojtjes së personit, të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shumë dispozita të tij (Kodit Penal) sigurojnë mbrojtje nga veprimet që dhunojnë integritetin fizik, mendor dhe seksual të një personi dhe drejtpërdrejt ose jo, sigurojnë për gratë mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna në përgjithësi. Në përmbajtjen e Kodit Penal janë parashikuar disa vepra penale që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me dhunën në familje.

2.2-a. “Vrasja me dashje”(neni 76 i K.P.), “Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër” (neni 77 i K.P.), “Vrasja me paramendim” (neni 78 i K.P.), përbëjnë krime

²² Shih Manualin faqe 16 dhe 17, ku janë përmendur sipas Kodit Penal veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

kundër jetës për të cilat parashikohen masa të rënda dënimi me burgim. Kodi Penal, mbështetur edhe në mbrojtjen e veçantë të gruas shtatzënë nga Kushtetuta, e parashikon vrasjen e kryer me dashje ndaj gruas shtatzënë, si vrasje të kryer në rrethana cilësuese. Në përputhje me shkallën e rëndë të kësaj vepre, Kodi Penal parashikon dënimin me burgim, jo më pak se njëzet vjet, ose me burgim të përjetshëm.

2.2-b. Tortura (neni 86 i K.P.) dhe "Tortura me pasoja të rënda" (neni 87 i K.P.) konsiderohen krime kundër shëndetit dhe dënimet e parashikuara për këto vepra janë të rënda. Legjislacioni ynë penal mbron në mënyrë të posaçme shëndetin e personit, pavarësisht nga përkatësia gjinore.

2.2-c. Plagosja e rëndë me dashje (neni 88 i K.p.), përveç elementeve të tjera, përfshin edhe atë të ndërprerjes së shtatzënisë.

2.2-d. Shfrytëzimi për prostitucion (neni 114/a) e parashikon mbrojtjen e femrës nga prostitucioni. Vitet e fundit, prokuroria dhe gjykata po përballen me regjistrimin e rasteve të shfrytëzimit të pjesëtarëve të familjes, kryesisht të bashkëshortes, për prostitucion. Shfrytëzimi i lidhjeve gjinore dhe shoqërimi i kësaj vepre me dhunë fizike apo psikike përbëjnë rrethana rënduese.

2.2.e. Shkaktimi i vetëvrasjes, (neni 99). Nëse një individ, si rrjedhojë e rrahjeve, fyerjeve të rënda, mundimeve apo formave të tjera të dhunës të ushtruara nga familjari i tij/i saj kryen tentativë për vetëvrasje ose vetëvritet, Kodi Penal e parashikon këtë rast si vepër penale dhe jep dënime alternative me gjobë ose burgim gjatë në pesë vjet.

2.2.dh. Nderprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas, (neni 93). Ka të bëjë me detyrimin e gruas nga bashkëshorti ose nga çdo pjesëtar i familjes për të ndërprerë shtatzëninë.

2.2-k. Liria seksuale mbrohet në mënyrë të posaçme. Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me një grua të rritur përbën një krim (neni 102 i K.P.). Kjo dispozitë duhet të zbatohet njëloj edhe për rastet kur çifti është i martuar ose kur personat bashkëjetojnë.

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me kërcënim (neni 104 i K.P.) parashikohet si figurë e veçantë krimi. Në rastet e përdhunimit të gruas nga bashkëshorti konfigurohet e njëjta vepër penale, por me ndryshimin se subjekti është i posaçëm.

2.2-ç. Dispozitat për kundërvajtjet penale

Kodi ynë penal parashikon mbrojtjen nga kundërvajtjet penale, disa prej të cilave mund të kryhen në marrëdhëniet familjare. Kështu, ai siguron mbrojtje nga:

- "Plagosja e lehtë me dashje" (neni 89 i K.P.),
- "Dëmtime të tjera me dashje (neni 90 i K.P.). (ku futen rrahja dhe çdo vepër tjetër dhune).
- "Plagosja e rëndë nga pakujdesia" (neni 91 i K.P.),
- "Plagosja e lehtë nga pakujdesia" (neni 92 i K.P.),

- "Kanosja serioze për vrasje ose për plagosje të rënde" (neni 84).

Dëmtime të tjera me dashje, ku futet dhe rrahja është një ndër veprat penale më të përhapura në marrëdhëniet familjare, ajo dënohet me gjobë. Nëse rrahja apo vepra të tjera të dhunës shkaktojnë paaftësi të përkohshme deri në 9 ditë, Kodi Penal parashikon dënime alternative me gjobë ose me burgim, gjer në gjashtë muaj. Mendojmë se nuk duhet të ndiqet e njëjta politikë, si kur rrahja kryhet nga një i huaj (jashtë familjes), ashtu edhe kur ajo kryhet nga bashkëshorti apo pjesëtarë të tjerë të familjes në mënyrë sistematike. Parashikimi me një paragraf të veçantë i një mase më të rëndë dënimi për rrahjen në marrëdhëniet familjare do të siguronte një mbrojtje më të mirë të gruas nga dhuna. Kjo mund të rekomandohet edhe për kundërvajtje të tjera penale që mund të kryhen në marrëdhëniet familjare.

"Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë" (neni 130 i K.p.). Kjo vepër parashikohet ndër veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes dhe dënohet me gjobë ose burgim gjer në tre muaj.

"Fyerja" përbën një vepër penale për të cilën parashikohen masa alternative dënimi, me gjobë ose burgim gjer në gjashtë muaj, por nuk ka një kulturë të konsoliduar për të denoncuar fyerjen në marrëdhëniet familjare. Megjithëse parashikohen masa më të larta dënimi kur kjo vepër kryhet në mënyrë sistematike, viktimat e dhunës psikologjike pak i referohen kësaj dispozite për mbrojtje.

Vështirësitë e të provuarit të dhunës psikologjike, mendësia shoqërore, niveli i pamjaftueshëm i njohjes së të drejtave ligjore nga qytetarët, mungesa e besimit në ndëshkimin efektiv të kësaj vepre, si dhe frika se bërja publike mund të sjellë probleme në mbarëvajtjen e marrëdhënies familjare, i step viktimat e dhunës në familje për të denoncuar.

Ligjvënësi e ka parë mbrojtjen e familjes të lidhur ngushtë me interesin më të lartë të fëmijës. Kështu, Kodi Penal parashikon mbrojtje nga vepra "Marrja e padrejtë e fëmijës" (neni 127 i K.P.), apo dhe "Mosdhënia e mjeteve për jetesë" (neni 125 i K.P.). Këto dispozita janë të rëndësishme për mbrojtjen e gruas dhe të fëmijës, duke qenë se në një pozitë të tillë ata ndodhen shpesh.

Mbrojtja e jetës private të personit që garantohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, gjen shprehje edhe në dispozitat e Kodit Penal. Kështu, parashikohet si kundërvajtje penale vendosja e aparaturave me qëllim regjistrimin e fjalëve apo fiksimit të figurave, transmetimin dhe publikimin e tyre, që bëjnë publike aspekte të jetës private të personit, pa pëlqimin e tij. Kjo vepër mund të ndodhë edhe në marrëdhënie familjare.

2.2-f. **Rrethanat rënduese**

Kodi ynë Penal parashikon disa rrethana rënduese në kryerjen e veprës penale, të cilat mund të sjellin rritje në masën e dënimit. Ndër rrethanat rënduese që mund të gjejnë zbatim në situatat e dhunës në familje përmendim veçanërisht:

- Kryerja e veprës duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, të miqësisë dhe të mikpritjes.

Rrethana rënduese është e lidhur me faktin se, kur vepra penale kryhet ndaj pjesëtarëve të familjes, janë cënuar jo vetëm ato marrëdhënie që mbrojnë, sipas rastit, jetën, shëndetin apo dinjitetin e personit, por edhe një mori marrëdhëniesh shumë të rëndësishme që ekzistojnë midis personave me lidhje familjare dhe gjinore.

- Konsiderohet si e kryer në rrethana rënduese edhe një vepër penale që kryhet ndaj fëmijëve apo gruas shtatzënë.
- Në mënyrë të ngjashme, rëndon dënimin kryerja e veprës ndaj personave të pazotë për t'u mbrojtur.

K R E U V

PROÇEDURAT STANDARTE QË DUHET TË ZBATOJË PUNONJËSI I POLICISË PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE.

1. Vështrim mbi praktikat e policisë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Viktimat e dhunës në familje, zakonisht për herë të parë kontaktojnë me punonjësit e policisë. Si rezultat, punonjësit e policisë luajnë rol thelbësor në krijimin e besimit dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë. Ndodh që punonjësit e policisë të jenë shumë më të ndjeshëm ndaj dhunës së ushtruar në mjediset publike, sesa ndaj dhunës në mjediset private. Krimet që kanë të bëjnë me dhunën ndaj gruas në familje, nuk trajtohen me të njëjtin seriozitet si edhe llojet e tjera të krimeve nga policia. Janë kryer studime dhe intervista të shumta nga OJF të ndryshme dhe me gjithë përmirësimet e dukshme në qëndrimin e policisë, ka raste (ndonëse të veçuara) kur punonjësit e policisë pretendojnë se gruaja e dhunuar tregon një histori të rreme dhe arrijnë deri aty sa të mendojnë se ajo e ka merituar dhunën e pësuar.

Ligji “Për Policinë e Shtetit”, parashikon: “Ndërhyrja dhe kontrolli në mjedise mund të bëhen pa lejen e pronarit, nëse është e nevojshme të parandalohet një kërcënim i çastit për jetën dhe shëndetin.” Pra, në rast se është e nevojshme, kur ka fakte të mjaftueshme për të dyshuar se një individ familjar po sulmohet apo po dhunohet, kjo dispozitë i jep kompetencë policisë të hyjë me forcë në një banesë private.²³

Regjistrimi, identifikimi i shenjave paraprake të dhunës në familje për të penguar pasoja më të rënda, nuk kryhet gjithmonë me përgjegjësi nga organet përkatëse. Ka raste, megjithëse sporadike, p.sh. kur një grua dhunohet në mënyrë sistematike, policia nuk regjistron çështjen në të gjitha rastet.

Moment shumë i rëndësishëm në trajtimin nga policia të viktimave të dhunës është edhe pyetja e dëshmitarit që, në disa raste, mund të jetë dhe i dëmtuari nga vepra penale. Kodi i Procedurës Penale, parashikon rregullat për pyetjen e dëshmitarit. Në nenin 361, pika 3 thuhet: “Ndalohen pyetjet që ndikojnë keq në paanësinë e dëshmitarit ose që synojnë në sugjerimin e përgjigjeve”.

Në paanësinë e dëshmitarit ndikojnë për keq edhe pyetjet me tone të ashpra dhe provokuese, të cilat mund ta bëjnë atë të tërheqë deklarin e bërë. Policia, me veprimet e saj duhet të fitojë besimin e viktimës në mënyrë që të jetë në gjendje të grumbullojë gjithë informacionin e duhur për të vazhduar hetimin deri në fund.

²³ Ligji nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 112

Punonjësi i policisë nuk duhet të harrojë që krimi, mund të jetë ngjarje rutinë, për vetë atë, por për viktimën ai mund të jetë një traumë e vërtetë që kërkon nga ai të jetë i gjindshëm, i duruar dhe i sjellshëm.

Disa gra që vijnë nga situata të dhunshme, tregojnë se ndërhyrja e policisë ndonjëherë e ka përkeqësuar situatën. Pas largimit të uniformave, burrat janë ndier edhe më të fyer dhe kanë ushtruar dhunë të përshkallëzuar ndaj bashkëshorteve që i kanë denoncuar.

Në disa raste, dhunuesit mbahen vetëm për disa orë në mjediset e policisë dhe më pas lirohen. Kjo masë nuk e ka zgjidhur problemin, por vetëm e përkeqëson situatën, në dëm të viktimës. Gjithashtu, lirimi i menjëhershëm i dhunuesit nga policia ka përbërë rrezik për viktimat e dhunës dhe ka ulur besimin e tyre për t'iu drejtuar policisë në raste të përsëritura të dhunës.

Policia duhet ta pajisë viktimën me vendimin për kryerjen e një ekspertimi mjekoligjor. Këtë duhet ta kryejë menjëherë edhe në rastet kur mendon se ka ndodhur një akt, i cili mund të ndiqet vetëm nëpërmjet akuzës private, në gjykatë.

Praktika ka evidentuar raste që tregojnë se punonjësit e policisë parapëlqejnë të mos konfliktohen me dhunuesit dhe e këshillojnë viktimën të rikthehet në shtëpinë bashkëshortore ose familjen ku është ushtruar dhunë. Kështu, viktimat tregojnë për raste ngurrimi të ndërhyrjes së policisë për ndalimin e dhunuesit, që tregojnë mungesën e ndjeshmërisë së policisë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Sidoqoftë, këto raste, nuk mund të mohojnë përmirësimet që janë vënë re në praktikën e trajtimit nga ana e policisë të viktimave të dhunës në familje.

Përveç hetimit dhe grumbullimit të provave, roli i policisë konsiston edhe në referimin e rastit në agjencitë e tjera që ofrojnë mbrojtje, gjë që është përmirësuar edhe për shkak të trajnimeve të vazhdueshme vitet e fundit. Kështu, këto përmirësime dallohen në lidhjet më të mira e referimin që policia u ka bërë viktimave të dhunës në familje pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore, strehëzave për gratë dhe vajzat e dhunuara, shërbimeve psiko-sociale dhe ligjore të ofruara nga shoqëria civile etj.

Punonjësi i Policisë së Shtetit ka detyrimin ligjor, për të orientuar dhe informuar viktimën e dhunës në familje për proceset ligjore që mund të nisnin, mbi faktin që ajo/ai është dhunuar.

Kodi Etik i Policisë shënoi një arritje në mënyrën e trajtimit të viktimave. Praktika tregon se, nëpërmjet vendosjes së rregullave të qarta procedurale, autoriteti i policisë rritet dhe zgjerohet.

Gratë mund t'u drejtohen organeve përkatëse dhe të ankohen për mënyrën si janë trajtuar nga policia. Në qoftë se gruaja raporton krimin dhe policia nuk vihet në lëvizje, ajo mund të hapë proces penal kundër policisë. Gjithashtu, ajo mund të bëjë ankesë në zyrën e Avokatit të Popullit për dhunim të të drejtave të saj.

2. Ndërhyrjet e punonjësit të policisë në rastet e dhunës në familje.

Punonjësi i policisë ndërhyr në rastet e dhunës në familje:

- Për të respektuar ligjin.
- Për të parandaluar dhe reduktuar dhunën në familje në të gjitha format e saj nëpërmjet mjeteve që i atribuon ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe ligji nr.9749, dt. 04.06.2007 “ Për Policinë e Shtetit”.
- Për të garantuar mbrojtje ligjore, veçanërisht siguri, për anëtarët e familjeve që i nënshtrohen dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.
- Për të ndëshkuar dhunuesin.
- Për të reduktuar recidivizmin dhe nevojën për t’u kthyer në të njëjtin vend në mënyrë të përsëritur.
- Për të parandaluar dëmtimet e rënda dhe vrasjet duke ndërhyrë që në nivelet e para të dhunës.

3. Detyrat e Punonjësve të Policisë që Shërbejnë në Sallat Operative e Emergjencës.

Veprimet e para të punonjësit të policisë që shërben në sallën operative në momentin kur merr një telefonatë për dhunë në familje në kuptim të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, janë të një rëndësie të veçantë dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin në zbatim të ligjit nr.9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Ai duhet:

- Të trajtojë me përparësi çdo telefonatë që përfshin një incident të dhunës në familje, e cila sapo ka nisur apo është në zhvillim e sipër.
- Të dërgojë menjëherë në vendin e ngjarjes që ka të bëjë me dhunë në familje jo më pak se dy punonjës policie; mundësisht njëri prej tyre të jetë femër.
- Të vlerësojë telefonatën për rastin e dhunës në famije si rast urgjence për ndihmë të menjëhershme dhe më pas të marrë të gjitha masat për njoftimin dhe dërgimin në vendin e ngjarjes të grupit hetimor për kryerjen e veprimeve proceduriale.
- Të mënjanojë çdo koment që e bën viktimën përgjegjëse apo që ul rëndësinë e incidentit.

Veprimet e punonjësve të policisë që shërbejnë në sallat operative dhe të emergjencës gjatë zhvillimit të bisedës në telefon me viktimën apo persona të tjerë:

Në sallat operative dhe emergjencës të jenë të regjistruar numrat e kontaktit (telefon e fax) të OJF-ve, qendrave shëndetësore, sociale, etj, që trajtojnë çështjet e dhunës në familje në juridiksionin e drejtorisë dhe komisariateve të policisë, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara midis tyre.

Punonjësi i policisë që shërben në sallat operative dhe emergjencës ka detyrë dhe përgjegjësi:

- a) të ketë parasysh ndjeshmërinë e viktimës,
- b) të vlerësojë informacionin nga personat që marrin në telefon herë pas here, sepse ata (personat telefonues) mund të jenë persona që përballen me këto raste të dhunës familjare në mënyrë sistematike.
- c) të udhëzojë personelin përkatës që të shkojë në vendin e ngjarjes, për t'i ardhur viktimës në ndihmë.
- d) të mbledhë informatat e para gjatë marrjes së telefonatës. (Informata fillestare, e regjistruar nga pranuesi i thirrjes, mund t'u japë informacion të rëndësishëm punonjësve të policisë përgjegjës, po ashtu, këto informata ndihmojnë në procesin gjyqësor)
- e) t'i bëjë pyetje telefonuesit gjatë bisedës duke mbajtur shënimet përkatëse në librin e tij.

3.1.a Pyetjet që duhet t'i bëjë punonjësi i policisë telefonuesit.

Në librin e vet, punonjësi i policisë i sallës operative dhe emergjencave duhet t'i bëjë këto pyetje telefonuesit, duke marrë e regjistruar saktë përgjigjet e tij dhe të sigurojë informacionin e mëposhtëm:

1. Si quhet telefonuesi?
2. A është telefonuesi vetë viktimë?
3. Nëse jo, a ka qenë i pranishëm telefonuesi në këtë incident?
4. Cila është situata urgjente?
5. Kur ka ndodhur incidenti apo është duke u zhvilluar në këtë moment?
6. Ku po zhvillohet situata urgjente? (adresa e saktë ose e orientuar (në afërsi-përballë-majtas-djathtas, etj) me objekte të tjera publike)
7. A ka të dëmtuar, me qëllim që të sillen ndihma e parë mjekësore?
8. A ka nevojë për ambulancë? Në qoftë se po, policia menjëherë njofton dhe dërgon ambulancën për ndihmë mjekësore.
9. A ka nevojë për zjarrfikëse? Në qoftë se kemi të shoqëruar dhunën me vënie zjarri, policia njofton menjëherë zjarrfikëset për të dhënë ndihmën e duhur.
10. A janë përdorur armë?
11. Të çfarë lloji?
12. Cili është dhunuesi, a njihet nga telefonuesi?
13. Cila është marrëdhënia ndërmjet telefonuesit dhe dhunuesit?
14. Ku gjendet dhunuesi tani?

15. Cili është përshkrimi fizik i dhunuesit?
16. Ndonjë nga personat e përfshirë në këtë dhunë a ka përdorur lëndë narkotike apo alkool?
17. Ka ndonjë urdhër mbrojtjeje ndaj dhunuesit?
18. A ka qenë policia në këtë adresë apo tek këta njerëz më parë?
19. A ka dëshmitarë të tjerë?
20. Si quhen ata (dëshmitarët)?
21. A ka fëmijë aty?
22. Sa vjeç janë (fëmijët)?

3.1-b Detyrat mbas përfundimit të bisedës me telefonuesin:

Mbas përfundimit të bisedës me telefonuesin punonjësi i policisë në sallën operative dhe emergjencës ka për detyrë:

1. Të njoftojë strukturën policore përgjegjëse (patrullën e përgjithshme që është në shërbim, Inspektorin e Policisë së Zonës, Inspektorin e policisë kriminale), mbi telefonatën që ka marrë. E informon mbi atë që ka ndodhur, e lejon të vazhdojë detyrën e tij/saj për verifikimin e gjendjes së viktimës dhe kryerjen e veprimeve të mëtejshme, kërkon informacion të vazhdueshëm prej tij/saj.
2. Të mos ndërpresë marrjen e masave mbi rastin e dhunës në familje në qoftë se merr ndonjë telefonatë që thotë se nuk ka nevojë për policinë të arrijë në vendin e ngjarjes. Kjo mund të ndodhë sepse telefonata mund të jetë bërë nga një person që është kërcënuar për të bërë një gjë të tillë.
3. Në qoftë se viktimë është sulmuar seksualisht, marrësi i telefonatës duhet t'i thotë viktimës që të mos lahet a të ndryshojë rrobat.
4. Çdo shpërthim emocional i viktimës dhe çdo informacion që viktimë i jep oficerit të policisë, duhet të regjistrohet.
5. Të njoftojë për të ardhur në vendngjarje punonjës të qendrave të ndryshme sociale e OJF, që merren me trajtimin e viktimave të dhunës seksuale, duke shfrytëzuar për këtë memorandumet e bashkëpunimit të policisë me këto organizma.

4. Përgjegjësitë dhe detyrat e patrullës së përgjithshme dhe të punonjësit të policisë në zonë.

Patrulla e përgjithshme e policisë dhe punonjësi i policisë në zonë, në rastet e trajtimit të dhunës në marrëdhëniet familjare kanë përgjegjësi dhe për detyrë:

- të reagojnë menjëherë ndaj telefonatave për dhunë familjare, pa marrë parasysh a është raportim i menjëhershëm apo i vonuar.
- të vlerësojnë faktin se janë personat e parë që shkojnë në vendin e ngjarjes ku bëhet fjalë për dhunë në familje.
- të vlerësojnë faktin se janë personat më të rëndësishëm në situatat e dhunës familjare.
- të luajnë një rol kryesor në sigurimin e provave
- të luajnë rol kryesor për bashkëpunimin me viktimën për të mundësuar më vonë një rast eventual për ndjekje penale.

4.1. Detyrat e patrullës së përgjithshme të policisë dhe punonjësit të policisë së zonës gjatë afrimit për në vendin e ngjarjes:

Patrulla e përgjithshme e policisë dhe punonjësi i policisë zonës, duhet të marrin informacionin që disponon marrësi i telefonatës (punonjësi i sallës operative) para se të arrijnë në vendin e ngjarjes dhe duhet ta njoftojnë atë kur arrijnë në vendngjarje. Momenti më i rrezikshëm për patrullën e përgjithshme dhe punonjësien e policisë së zonës është kur ai/ajo i afrohet vendit të ngjarjes, konkretisht vendbanimit.

Në këto raste rekomandohet që në qoftë se është e mundur, të dërgohen jo më pak se dy punonjës policie.

4.1-a. Procedurat që duhet të zbatojnë patrulla e përgjithshme e policisë dhe inspektori i policisë në zonë, kur i afrohen vendbanimit.

- Të shmangë përdorimin e borisë së mjetit dhe dritave të emergjencës dhe t'i përdorë ato vetëm atëherë kur është e nevojshme që të rritet shpejtësia e lëvizjes së mjeteve të tyre.
- Të mos parkohen makinat e policisë para shtëpisë ose në një vend ku përbën pengesë.
- Të jetë vigjilent për personat që mund të largohen nga vendi i ngjarjes si dhe për armët që mund të përdoren nga dyert, dritaret apo nga automjetet përreth.

4.1-b. Pas trokitjes në derë dhe pas ballafaqimit me ndonjë banor të asaj shtëpie, polici përgjegjës duhet:

- Të prezantojë veten si punonjës policie,
- Të sqarojë pse ndodhet aty dhe të kërkojë të hyjë në shtëpi (banesë)
- Të kërkojë të shohë viktimën. Punonjësi i policisë, nuk duhet të tregojë emrin e personit që ka bërë thirrjen.
- Të jetë i prerë në kërkesën e tij për ta parë viktimën dhe për të biseduar vetëm me të, në rast se atij (policit) nuk i lejohet hyrja në vendin e ngjarjes.
- Nëse pengohet takimi me viktimën, atëherë ai duhet të kontaktojë (nëpërmjet mjeteve të komunikimit) me operatorin që ka marrë telefonatën dhe t'i kërkojë atij ndihmë për punonjës ose mjete të tjera policie, me qëllim kryerjen normale të detyrave të tij funksionale për rastin në fjalë.

4.1-c. Detyrat e Patrullës së Përgjithshme të policisë dhe të punonjësit të policisë së zonës me të mbërritur në vendngjarje.

Patrulla e përgjithshme, punonjësi i policisë në zonë me të mbërritur në vendngjarje ka përgjegjësi dhe kryen këto detyra:

1. Të trokasë në derë vetëm pasi ka kontrolluar vendin përreth dhe të sigurohet se nuk i kërcënohet jeta.
2. Të mbajë distancë për të vepruar (reaguar) nëse ndodh ndonjë situatë e papritur.
3. Të përshtasë reagimin sipas intensitetit të telefonatës që u është dhënë nga salla operative dhe emergjencës.

4. Të përgjigjet në mënyrë emergjente duke përdorur dritat e emergjencës dhe borinë e automjetit të tyre nëse sulmuesi është prezent dhe ka ende rrezik.
5. Të vlerësojë situatën dhe të kërkojë forca të tjera policore për ta zgjidhur atë.
6. Të lajmërojë sa më shpejt që të jetë e mundur të gjithë personat e përfshirë në këtë situatë, nëse autori ka ikur nga vendi i ngjarjes
7. Të vendosë rregull duke e marrë situatën nën kontroll.
8. Të ndajë të gjitha palët që janë të përfshira në incident.
9. Të konfiskojë të gjitha armët e gjetura në vendin e ngjarjes në cilësinë e provave dhe për të mbrojtur personat e tjerë që janë të pranishëm.
10. Të tregojë kujdes në mbledhjen e provave.
11. Të japë dhe të sigurojë ndihmë mjekësore për personat e dëmtuar.
12. Të bëjë kujdes dhe të sigurojë vendin e ngjarjes sipas metodikave të "Ruajtjes së vendit të ngjarjes".
13. Të bëjë ndarjen fizike të dëshmitarëve të rastit dhe të krijojë mundësi për intervistimin e tyre.
14. Të shënojë të gjitha informatat e dhëna sa më saktë që të jetë e mundur.
15. Të evidentojë dhe vlerësojë informacionet e dhëna nga mjeku i urgjencës, nga punonjësi social i Bashkisë ose Komunës dhe i OJF-ve, si nëpërmjet intervistimit, ashtu dhe dërgimit me shkrim të informacioneve prej tyre.
16. Të mbledhë dhe shënojë të gjitha provat duke përfshirë fotografitë e dëmtimeve fizike dhe të shkatërrimeve të pasurisë.
17. Të përcaktojë nëse ekziston një shkak i mundshëm i krimit, duke u bazuar në informatat e marra apo të gjetura në vendin e ngjarjes.
18. Të identifikojë dhunuesin dhe të bëjë arrestimin e tij/saj - nëse ekziston një shkak ligjor.
19. Të marrë masa për kapjen e personit dhunues në qoftë se ai është larguar nga vendi i ngjarjes duke:
 - a. Kontrolluar vendin për ta kërkuar.
 - b. Marrë informata se ku mund të ketë shkuar ai/ajo.
20. Të kërkojë fletë arresti për autorin, për krimin (krimet), rrethanat e të cilave i krijojnë bindje se ai i ka kryer.
21. Të përpilojë dokumentacionin e saktë dhe t'ia përcjelle organit të hetimit.
22. Të mbajë shënim gjithë veprimet hetimore që ka kryer, nëse është konstatuar një veprim i dhunshëm, por agresori nuk mund të përcaktohet. Të shënojë në raportin e tij/saj çdo veprim që ka ndërmarrë për të parandaluar ndonjë akt tjetër dhune.
23. Të përdorë të gjitha mjetet dhe mënyrat e mundshme për ta mbrojtur viktimën e për të parandaluar keqtrajtimet e tjera që mund të ndodhin dhe të marrë disa masa si më poshtë (*por jo vetëm këto*):
 - të sigurojë mbrojtje, për personin që ka raportuar dhunë, sipas ligjit "Për mbrojtjen e dëshmitarëve".
 - të ndihmojë viktimën, që ajo të marrë sendet e nevojshme personale - në rast se viktima vendos të largohet nga banesa e përbashkët.
 - të qëndrojë në banesë, për t'i paraprirë kthimit të sulmuesit në banesën e përbashkët për marrjen e sendeve të tij ose të viktimës.
 - të përkujdeset për sigurinë e fëmijëve.

- të bëjë të mundur shoqërimin e viktimës dhe të fëmijëve apo pjesëtarëve të tjerë të familjes në një vend të përshtatshëm të sigurt duke respektuar dhe vullnetin e viktimës. (Të shfrytëzohen memorandumet e bashkëpunimit me qendra dhe OJF që ofrojnë shërbime strehimi për viktimat e dhunës në familje).

24. Të përfundojë të gjitha raportet e incidentit/krimin në kohë, duke shfrytëzuar dhe informacionet e marra nga qendrat mjekësore, OJF-të, punonjësit socialë dhe t'ia dërgojë eprorit përgjegjës, i cili ia përcjell menjëherë shefit të seksionit të policisë kriminale për veprime të mëtejshme.

4.1-d Raporti me shkrim për incidentin.

Përgjegjësitë e Patrullës së Përgjithshme për përpilimin e tij.

Patrulla e përgjithshme e policisë, pas trajtimit të një incidenti përpilon “Raportin me shkrim për incidentin”, i cili është një dokument – formular. Një model formulari mund të gjendet në Shtojcën A të këtij manuali.

Për rastet e incidenteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje, në formularin tip për “Viktimën” dhe “Dëshmitarin”, në një hapësirë të tij plotësohet për të treguar se incidenti është rast i dhunës në familje, duke qarkuar gjithashtu marrëdhënien ndërmjet palëve. Gjatë përpilimit të këtij formulari punonjësi i policisë ka për detyrë:

- Të dokumentojë çdo element për secilën vepër, duke mbajtur parasysh faktin se mund të kemi më shumë se një për shkak të përkeqësimit të situatës.
- Të dokumentojë shkeljen e urdhërit të mbrojtjes, nëse ka të tillë.
- Të dokumentojë në proces-verbal dhe fiksojë me fotografi çdo dëmtim, dërmishje, skuqje në trup dhe përshkrime të shkruara të tyre.
- Të dokumentojë dhe fiksojë sipas metodikave të përcaktuara provat fizike si p.sh.: dëmtime të ndryshme fizike në mure, dyer e dritare të thyera, mobilje të dëmtuara, etj.
- Të dokumentojë incidentet e mëparshme të raportuara ose jo pranë policisë.
- Të përshkruajë (citojë) në detaje dhe jo në mënyrë të përmbledhur fjalët e viktimës, të dyshuarit dhe dëshmitarëve.
- Të përshkruajë gjendjen emocionale të të gjitha palëve në incident.
- Të përcaktojë nëse ka pasur fëmijë, të moshuar apo persona me aftësi të kufizuara të pranishëm apo të lënduar gjatë incidentit.
- Të fiksojë dhe dokumentojë në proces-verbalin e pyetjes, nëse viktima ka qenë shtatzënë në momentin e incidentit.

5. Detyrat gjatë hetimit dhe intervistimit

Disa parime të përgjithshme, të cilave punonjësi i policisë duhet t'u kushtojë vëmendje gjatë hetimit dhe intervistimit.

Punonjësi policisë i caktuar për rastet e dhunës në familje, gjatë hetimit dhe intervistimit duhet të ketë parasysh disa parime të përgjithshme:

1. T'u japë përparësi rasteve të dhunës në familje, në raport me rastet e dhunshme e jo të dhunshme, që të sigurojë mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në konflikt.
2. Të sigurojë që autori të kapet sa më shpejt që të jetë e mundur.
3. Të përgatisë dokumentat me prova të sakta ligjore, sa më shpejt të jetë e mundur dhe t'ia dërgojë ato organit të hetimit për ndjekje penale të mëtejshme.
4. Të bashkëpunojë me viktimën dhe dëshmitarin, t'i ndihmojë ata.
5. Të mbrojë viktimat dhe dëshmitarët nga kërcënimet e ndryshme.
6. Të marrë njoftim në vazhdimësi për veprimet e ndërmarra nga ana e gjykatës, për rastet e paraqitura.

Detyrat e punonjësit të policisë gjatë hetimit në vendngjarje.

Gjatë hetimit në vendngjarje punonjësi i policisë duhet të kryejë një hetim të plotë dhe të përgatisë një raport pavarësisht nga dëshira e viktimës apo prania ose mungesa e të dyshuarit. Ai gjatë hetimit në vendngjarje duhet të përdorë disa teknika policore dhe të kryejë këto detyra:

1. Të afrohet me kujdes në vendngjarje (sipas rastit) dhe të shohë e dëgjojë se çfarë po ndodh përpara se të bëjë të ditur praninë e tij.
2. Të përcaktojë vendndodhjen dhe kushtet e viktimës dhe të dyshuarit.
3. Të përcaktojë nëse është përdorur armë, nëse në banesë apo në ambientin përreth saj ka armë.
4. T'u japë ndihmë palëve të dëmtuara dhe nëse e vlerëson, të njoftojë një ambulancë.
5. Të dokumentojë emrin dhe informacionin për të kontaktuar mjekun, tek i cili/e cila është vizituar viktimat.
6. Të përcaktojë nëse ka persona të tjerë në banesë apo ndërtesën ku është ushtruar dhuna.
7. Të mbajë veç të dyshuarin, viktimën dhe dëshmitarët përpara se t'i pyesë ata.
8. Të evidentojë në proces-verbal deklaratat e tyre ashtu sic thuhet dhe jo si përmbledhje të mendimeve që ka dashur të shprehë i intervistuari.
9. Të dokumentojë dhe fotografojë të gjitha dëmtimet trupore.²⁴

²⁴Kodi i Procedurës Penale, neni 188

10. Të fiksojë sipas të gjitha rregullave procedurale gjendjen statike të vendngjarjes (proces-verbal, fotografi dhe skicë).
11. Të fiksojë me proces-verbal, fotografi apo filmim armët e mjete të tjera të ushtrimit të dhunës me cilësinë e provave materiale. Përshkrimi i tyre në proces-verbal duhet bërë i detajuar.
12. Të marrë informacion se kush njoftoi sallën operative të policisë. Nëse ka patur njoftim të tillë, të sigurojë një kopje të Regjistrit të Ngjarjeve për ditën kur është regjistruar telefonata dhe të njihet me masat paraprake të marra.
13. Të vlerësojë gjendjen emocionale të të gjithë personave në konflikt.
14. Të vlerësojë informacionet e marra nga mjekët, punonjësit sociale të bashkive, komunave e OJF-ve, si pjesë e informacionit të siguruar për hetim.

5.3. Rregullat - parimet e punonjësit të policisë gjatë intervistimit të viktimës, të dyshuarit dhe dëshmitarëve

Punonjësi i policisë që merret me hetimin, gjatë intervistimit të viktimës duhet të ketë parasysh disa parime - rregulla:

5.3-a. Intervistimi i viktimës:

- duhet ta bëjë viktimën që të ndjehet se deklarata e tij/saj është e rëndësishme.
- duhet të tregojë kujdes për viktimën, zëri i punonjësit të policisë, shikimi dhe fjalët që zgjedh ai/ajo, do të shërbejnë për të transmetuar këtë mesazh: *policia ndodhet aty për të ndihmuar.*
- duhet të tregojë kujdes për sigurinë e viktimës, ta ndihmojë atë të heqë frikën dhe të jetë më e gatshme për të bashkëpunuar me zbatuesit e ligjit.
- Të mbajë gjithmonë parasysh se viktimës mund t'i jetë thënë nga dhunuesi se, nëse ajo kërkon ndihmë askush nuk do ta dëgjojë atë.
- Ta bindë viktimën se siguria e saj është prioritet për policinë dhe se viktima nuk është fajtorë.

5.3-b. Intervistimi i të dyshuarit:

- Të intervistojë të dyshuarin në një dhomë të ndarë nga viktima.
- Të qetësojë të dyshuarin nëse ai është i nervozuar.
- T'i bëjë të ditur të drejtat që ai gëzon sipas ligjit.
- Të mos i bëjë deklarata akuzuese të cilat mund ta vendosin të dyshuarin në pozitë mbrojtëse. Ju doni që i dyshuari të bashkëpunojë me ju gjatë intervistës.
- Të ketë parasysh gjendjen e tij emocionale.
- Të lërë të dyshuarin të tregojë ngjarjen vetë, para se ta ballafaqojë me informacionin që e konflikton atë.
- Të dokumentojë (shënojë) çfarëdo lloj deklarate të tij/saj.

- Të mos i tregojë subjektit, nëse ai pyet se mos viktima e ka thirrur policinë.

5.3-c. Intervistimi i dëshmitarëve:

- Të merren në pyetje të gjithë dëshmitarët veç e veç.
- Të identifikojë dëshmitarët dhe marrëdhëniet e tyre me viktimën dhe të dyshuarin.
- Të regjistrojë informacionin mbi emrat, adresat, numrat e telefonit dhe kontaktin e emergjencës, për çdo dëshmitar të intervistuar.
- Të mbajë shënime rreth sjelljes së dëshmitarëve dhe të marrë deklaratat me shkrim nga ata.
- Të pyesë fqinjët nëse ata kanë dëgjuar ose parë diçka.
- Të marrë nga dëshmitarët informacionet e nevojshme dhe të kuptojë nëse ata janë në dijeni të ndonjë ngjarjeje të tillë abuzimi.

5.3-d. Intervistimi i fëmijëve,

Nuk është e thënë që fëmijët të kenë qenë në të njëjtën dhomë dhe të kenë parë sulmin. Edhe në qoftë se viktima ose i dyshuari thonë që fëmijët ishin sipër duke fjetur, ka shumë të ngjarë që ata të jenë zgjuar nga incidenti dhe mund të japin një informacion shumë të vlefshëm për abuzimin e tanishëm ose abuzimet në të shkuarën.

Gjatë intervistimit të fëmijëve duhen zbatuar me korrektësinë më të madhe disa rregulla:

Kujdes në marrëdhëniet me fëmijët! Kujdes komunikimin me ta!

Fillimisht bëhet një komunikim i thjeshtë. Pyetet për moshën, shkollën, ecurinë në mësim dhe kur konstaton një qetësim psikologjik të fëmijës mund ta pyesë:

1. Çfarë ndodhi?
2. Kush ushtroi dhunë?
3. Ku ishe ti kur ndodhi kjo?
4. Kur ndodhi kjo?
5. A ka ndodhur dhe herë të tjera?

6. Disa rregulla të përgjithshme

KUJDES !

- ! *Punonjësi i policisë duhet të reagojë menjëherë, maksimalisht, me të gjitha mjetet që disponon (mjete të komunikimit dhe organizimit policor).*
- ! *Gjithçka eidentojeni me shkrim ne librin tuaj.*
- ! *Asnjëherë mos i besoni kujtesës.*

- ! *Ligji penal ne rastet e dhunës në familje duhet të zbatohet në të njëjtën mënyrë si në çdo rast tjetër kur ndodh një vepër penale.*
- ! *Punonjësi i policisë gjatë trajtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje nuk duhet të ndikohet nga:*
 - *Marrëdhënia apo gjendja civile e të dyshuarit dhe viktimës (të martuar, divorcuar, bashkëjetojnë, etj.),*
 - *Nëse i dyshuari jeton apo jo në banesën e viktimës,*
 - *Mungesa e një Urdhëri Mbrojtjeje,*
 - *Mundësia e pasojave financiare të arrestimit,*
 - *Gjendja emocionale e viktimës ose të dyshuarit (i dyshuari është zakonisht mjaft i qetë dhe nën kontroll, ndërsa viktima mund të jetë e shqetësuar pasi ka përjetuar dhunë),*
 - *Mungesa e plagëve të dukshme tek viktima (shumë dëmtime janë të brendshme dhe nuk duken përpara 24-48 orëve),*
 - *Vendndodhja e incidentit, psh. pronë publike apo private*

K U J D E S Gjatë komunikimit me viktimën !

- ! *Mos spekuloni me faktin se nuk mund të ngrihen dot akuza,*
- ! *Mos bëni sygjerime apo kërcënime për të dekurajuar viktimën për të bërë kallëzim për dhunën e ushtruar.*
- ! *Ndalohen shprehje apo pyetje te tilla si më poshtë:*
 - *Ju e dini se ne duhet ta arrestojmë bashkëshortin tuaj dhe ai nuk do të jetë në gjendje të punojë;*
 - *Kjo do ta nxehë atë më shumë;*
 - *Na duhet t'ju arrestojmë të dyve dhe kush do të kujdeset për fëmijët.*

Në rast se gjatë konfliktit në praninë tuaj, të dyja palët pretendojnë se është përdorur dhunë, evidentoni përgjigjet në mënyrë të saktë për pyetjet e mëposhtme:

- *Cila palë ka frikë nga tjetra?*
- *A e ka përshkallëzuar nivelin e dhunës ndonjëra nga palët?*
- *A ishte njëra nga palët më e madhe dhe më e fuqishme se tjetra?*
- *A ka patur incidente të mëparshme të dhunës të njerës prej paleve ndaj tjetrës, apo ndaj personave të tjerë ?*
- *A ka ndonjë rast të mëparshëm ku njëra nga palët ka qënë dhunuesi?*
- *A është dëmtuar njëra nga palët më shumë sesa tjetra?*
- *A ka dëmtime që duken se janë shkaktuar për vetëmbrojtje, ose për të shpëtuar, p.sh.: të kafshuara, të djegur, gërvishtje, etj?*

7. Detyrat e punonjësve të policisë për zbatimin e Urdhërave të Mbrojtjes²⁵

7.1. Urdhërat e mbrojtjes. Përgjegjësitë e punonjësit të policisë.

- **Nëse nuk ka urdhër mbrojtjeje**, punonjësi i policisë duhet ta bëjë me dije dhe këshillojë viktimën për mundësinë që ajo ka për përfitimin e një urdhëri të tillë.
- **Nëse ka urdhër mbrojtjeje**, punonjësi i policisë duhet të lexojë me kujdes urdhërin për të parë se çfarë mbrojtjeje i siguron ai viktimës dhe çfarë kufizimesh/detyrimesh përcakton për të dyshuarin.
- **Nëse i dyshuari ka shkelur urdhërin e mbrojtjes**, punonjësi i policisë duhet ta arrestojë atë në përputhje me Nenin 320 të Kodit Penal për “Pengim në ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”.

7.2. Përgjegjësitë e punonjësve të Policisë së Shtetit në mbrojtje të viktimave.

Drejtoritë e policisë në qarqe janë një prej autoriteteve përgjegjëse sipas ligjit. (Neni 5 i ligjit) dhe sipas nenit 38 të tij të gjitha autoritetet duhet:

- të bashkërendojnë shërbimet,
- të caktojnë personat përgjegjës,
- t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat,
- të mbajnë raportet përkatëse
- t'i mbrojnë viktimat nëpërmjet informimit, sigurimit të transportit ose vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.

Sipas ligjit kundër dhunës në familje, **policia mund të paraqesë kërkesë për urdhër mbrojtje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.** (Neni 13)

Policia duhet të tregohet jashtëzakonisht e kujdesshme në zbatimin e kësaj dispozite në mënyrë që viktimës t'i bëhen me dije të drejtat e tij/saj për mbrojtje dhe të jetë e ndjeshme ndaj vullnetit që shpreh ajo. Shpesh viktimat është gjykatësi më i mirë i situatës së tij/saj

